



Pranuar / Dorezuar Puniljena/Prodato Received/Delivered	30.12.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	6442/2021		1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1181/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2466/2019 të datës 10.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.490/2019 të datës 22.08.2019 të parashtruar nga ankuesi më adresë fshati Bardh i Madh, rruga "UÇK" Nr.36 në Fushë Kosovë, kundër Vendimit me Nr. Prot: 1443 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.490/2019 e datës 22.08.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Prot: 1443 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në bazë të Akt Emërimit Nr. Ref.442/2013 të datës 06.06.2013 pozitën "Zyrtar i Logjistikes" në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në bazë të Vendimit me Nr.Prot:1048 të datës 18.06.2019 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike i është përfunduar marrëdhënia e punës me arritjen e moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtës e marrjes së një pagesë në shumën e një page mujore të njehershme në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi më datë 10.07.2019 ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot:1193 tek Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për pagesën e tri pagave sipas Marrëveshjes Kolektive. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike më datë 10.07.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:1195 me të cilin ka refuzuar kërkesën e datës 10.07.2019 të ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.Prot:1195 të datës 10.07.2019 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, më datë 15.07.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1231 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, me datë 14.08.2019 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot:1443 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot:1443 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3796/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.08.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Më datë 30.08.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 07.10.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 10.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2466/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 22.08.2019.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3796/2019 të datës 22.08.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:1443 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike; Vendimin me Nr.Prot:1195 të datës 10.07.2019 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike; Kërkesën e datës 10.07.2019 e ankuesit e parashtruar tek Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike; Ankesën e datës 15.07.2019 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike; Vendimin me Nr. Prot:1048 të datës 18.06.2019 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike; Kërkesën për Pagës retroaktive e datës 11.07.2019 Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 09.08.2019; Akt Emërimit Nr. Ref.442/2013 i datës 06.06.2013; E-mailin e datës 15.01.2019 për ankuesin nga dhe Përgjigjen në ankesë e datës 30.08.2019 me numër protokollit 3964/2019; Njoftimin e datës 07.10.2019 dhe Aktgjykimin A.nr.2466/2019 të datës 10.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuses e cila pretendon që t'i bëhet pagesa e tri pagave mujore për tre muajt e fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankuesit me rastin e pensionimit sipas i ka përfunduar sipas Vendimit me Nr.Prot:1048 të datës 18.06.2019, atëherë



kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet.

Bazuar në provat e lëndës, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, ankuesit i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, sipas dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*, rrjedhimisht Gjykata e Apelit e Kosovës ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot:1443 të datës 14.08.2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1181/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Znj.

-Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje

Administrative;

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së.